



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 04.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.04.2022 të parashtruar nga **Operatori Ekonomik "Rosi Trade" shpk, -, Peje**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale**, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Operatori Ekonomik "Rosi Trade" shpk, -, Peje**, të dt. 29.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale"**, me Nr. të Prok: : **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**, kundër *Njoftimit për kontrate* te AK –së, të datës 07.04.2022.

1. Vërtetohet Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues i dates 07.04.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin "Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale"*, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**, sipas Njoftimit për kontrate te publikuar me datën: 07.04.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Rosi Trade" shpk, -, Peje me datë 29.04.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale"**, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.05.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
AK ka bere Njoftimin per kontrate per kete aktivitetit te prokurimit gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat dhe Udhezuesin per Prokurimit Publik.

Ne LPP dhe ne RRUOPP ne nenin 27 Grupi i Operatoreve Ekonomik, perkatësisht ne nenin 27 te RRUOPP shkruan:

27.3 Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

27.4 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. Kjo do të thotë se AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit të OE.


Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontrate se lideri i grupit duhet të përmbush se paku 60% e këtij qarkullimi minimal.

AK –ka bere Njoftimin per kontrate gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

AK për te ndaluar keqpërdorimet – mashtrimet nga ana e Operatoreve Ekonomik te cilat janë te shumta, këtë kërkesë e ka përcaktuar edhe ne procedurat tjera te prokurimit dhe asnjëherë nuk është cilësuar si kërkesë e pa arsyeshme dhe e padrejte, pra është e drejte ekskluzive e zyrtarit te prokurimit për te caktuar kriteret e përzgjedhjes e jo e operatoreve ekonomik qe ti diktojnë kërkesat e tyre. AK Komuna e Prishtinës monitorohet edhe nga organet tjerat me te larta siç është KRPP por nuk ka pas asnjëherë asnjë shkresë nga ana e tyre se ky kriter është i padrejte, i pa arsyeshëm dhe diskriminues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit